



Njesia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/152 Nr. i faq./Br.str./No.pg 89

Data/Datum/Date 29.06 / 2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Nenit 21 paragrafi 2 pika 2.3 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. Prot. 1427 e datës 28.04.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.6.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2026

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/7508 i datës 15.06.2026 dhe merret vendimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Rahovecit në shumën prej 280€ (dyqind e tetëdhjetë euro) për çdo rast, për vitin 2026.
2. Në kuadër të shpenzimeve të varrimit bëjnë pjesë: Regjistrimin e rastit në librin amëz të të vdekurve, fletë lajmërimet (afishet), pastrimi i kufomës me mjetet higjienike për pastrim, hapjen e varrit, sigurimin e dërrasave, pëlhurën për mbështjelljen e kufomës (qefinit), piramidën me mbishkrim, transportin e kufomës nga shtëpia deri në varreza dhe kryerja e ritualeve të varrimit sipas parimeve fetare (përjashtimisht rasteve kur një gjë e tillë nuk kërkohet nga ana e qytetarëve të caktuar).
3. **OBLIGOHEN** Bashkësitë Fetare në Komunën e Rahovecit që në baza mujore të dërgojnë listën e personave të vdekur, duke bashkëngjitur Certifikatën e Vdekjes për çdo person të vdekur.
4. **AUTORIZOHET** Kryetari i Komunës që pas pranimi të listës sipas pikës 3 të këtij vendimi të merr vendim për ekzekutimin e mjeteve në shumën e cila do të jetë sipas listës dhe atë në xhirrollogari të Bashkësive Fetare.
5. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës që të formojë komision në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve për mbikëqyrjen e realizimit të këtij vendimi.
6. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve dhe transfereve.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive në Komunën e Rahovecit.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorëve të drejtorive,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.157/26
Datë:29.06.2026



Fatmir Iska

Kryesues i Kuvendit